



NJOFTIM PËR SHTYP

Parlamenti IV Rural Shqiptar mbledh rreth 300 pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria për të diskutuar të ardhmen e zonave rurale në rrugën drejt BE-së

Lezhë, 25 - 27 mars 2026 - Parlamenti IV Rural Shqiptar u zhvillua në Lezhë dhe Mirditë, duke mbledhur rreth 300 pjesëmarrës nga 61 bashkitë e vendit, përfaqësues të komuniteteve rurale, fermerë, të rinj, organizata të shoqërisë civile, institucione publike, academia dhe partnerë zhvillimorë, në një platformë të përbashkët dialogu dhe bashkëpunimi për zhvillimin rural në Shqipëri.

I organizuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), në bashkëpunim me bashkitë pritëse Lezhë dhe Mirditë, ky edicion u fokusua në temën: “Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së përmes partneriteteve, reformave dhe zhvillimit koheziv territorial”. Gjatë tre ditëve të aktivitetit, pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat dhe mundësitë që lidhen me procesin e integritimit evropian dhe ndikimin e tij në komunitetet rurale, duke theksuar nevojën për politika të bazuara në realitetin e territorit dhe për një qasje më të fortë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe aktorëve lokalë.

Koordinatorja Kombëtare e ANRD, Evelina Azizaj, në fjalën e vet hapëse, duke folur mbi atë se çfarë do të thotë integrimi evropian për fermerët, për të rinjtë, për gratë, për bashkitë, do të nënvizojë se përgjigja nuk mund të vijë nga një aktor i vetëm. "Integrimi kërkon partneritet. Kërkon bashkëpunim të vërtetë mes të gjithëve. Nuk është rastësi që jemi në Lezhë, një vend që historikisht simbolizon bashkimin dhe vendimmarrjen e përbashkët, tha zonja Azizaj.

Parlamenti filloi në Mirditë, me një aktivitet territorial të fokusuar në nxitjen e sinergjive për zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti. Kjo ditë vendosi bazat për bashkëpunime konkrete dhe për forcimin e iniciativave lokale për krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit.

Sesioni plenar i ditës së dytë që vazhdoi në Lezhë, vendosi kuadrin e përgjithshëm të diskutimit, duke reflektuar mbi atë se çfarë do të thotë konkretisht integrimi evropian për zonat rurale, bashkitë dhe komunitetet. Paneli theksoi rëndësinë e koordinimit ndërinstytucional, forcimit të kapaciteteve vendore dhe përfshirjes aktive të komuniteteve në proceset reformuese.

Punëtoritë tematike “Bisedat Rurale” sollën në qendër zërin e komuniteteve, duke adresuar çështje si zhvillimi lokal përmes qasjes LEADER, bujqësia e qëndrueshme, fuqizimi i grave, inovacioni, bujqësia familjare, ekonomia rurale dhe pastoralizmi. Nga këto diskutime u nxorën rekomandime konkrete që synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e politikave dhe programeve në sektorin bujqësor dhe rural.

Në përmbyllje të Parlamentit, mesazhet kryesore të dala nga diskutimet u prezantuan dhe u diskutuan me pjesëmarrësit, duke synuar ndërtimin e një qasjeje më të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin rural në Shqipëri.

Parlamenti Rural Shqiptar vijon të jetë një nga platformat më të rëndësishme kombëtare për dialog, advokaci dhe bashkëkrijim politikash në sektorin rural, duke kontribuar në forcimin e partneriteteve dhe afrimin e Shqipërisë me praktikën dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Për më shumë informacion lexoni në: <https://anrd.al/parlamenti-iv-rural/> Na kontaktoni në: info@anrd.al | +355 (0) 698558451